



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 64 paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 22 në paragrafin 1 nën paragrafi 1.5 dhe paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, si dhe neni 11 paragrafi 1,2,3 dhe 4 të Rregullores së Brendshme Nr. 10/2024, për Shtesat dhe Kompensimet në KQZ, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 14.11.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Kërkesës së Zëdhënësit të KQZ-së për Shtesën 30% për Punë pa Orar të Paracaktuar

- I. Miratohet kërkesa e Zëdhënësi i KQZ-së për shtesën 30% për punë pa orar të paracaktuar.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Bazuar në paragrafin 2 të nenit 11 paragrafi 2 të Rregullores së Brendshme Nr.10/2024 për Shtesat dhe Kompensimet në KQZ, pozita e zëdhënësit të KQZ-së hynë në kategorinë e kabinetit të KQZ-së dhe me përshkrimin e vendit të punës, te kushtet e punës është përcaktuar që zëdhënësi i KQZ-së, përveç orarit zyrtar të punës, punon edhe pa orar të paracaktuar.

Më qëllim të informimit për aktivitetet e KQZ-së, zëdhënësi i KQZ-së, sipas përshkrimit të detyrave të punës, duhet të jetë në gjendje gatishmërie pa ndonjë orar të caktuar për të përmbushur kërkesat e ligjshme të KQZ, mediave dhe akterëve tjerë në kohë sa më të shpejtë dhe mënyrë efikase për të siguruar informim dhe transparencë të publikut.

Andaj, duke u bazuar në sqarimet e mësipërme, u vendos si dispozitivin e këtij vendim

Prishtinë, 14.11.2024

Kreshnik RADONIQI

Kryesues i KQZ





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 dhe nenin 64 paragrafi 2.1. i Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 14.11.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Specifikave Teknike për Shtypjen e Doracakut të Trajnimit

- I. Miratohen Specifikat teknike për shtypjen e Doracakut të trajnimit, për procesin e votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2025 dhe zgjedhjet lokale 2025.
- II. Specifikat si në pikën I, janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 14.11.2024

Kreshnik RADONIQI

Kryesues i KQZ





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 dhe nenin 64 paragrafi 2.1. i Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 14.11.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Specifikave Teknike për Shtypjen e Distinktivëve

- I. Miratohen Specifikat teknike për shtypjen e distinktivëve, për procesin e votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2025 dhe zgjedhjet lokale 2025.
- II. Specifikat si në pikën I, janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 14.11.2024

Kreshnik RADONIQI
Kryesues i KQZ
Republika e Kosovës
Republika Kosova
Prishtinë
Priština
CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 59, 63 dhe 64 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 21 të Rregullores së Punës së KQZ, me datën 14.11.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Pjesëmarrjes në Simpoziumin Ndërkombëtarë Zgjedhor në Republikën Dominikane

- I. Miratohet pjesëmarrja e KQZ, në simpoziumin ndërkombëtarë zgjedhor në Santo Domingo, Republikën Dominikane, nga data 15-18 Dhjetor 2024.
- II. Pjesëmarrës në këtë vizitë janë:
 1. Kreshnik Radoniqi
 2. Alban Krasniqi
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 14.11.2024

Kreshnik RADONIQI

Kryesuesi KQZ





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 96 dhe nenin 97 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 8 të Rregullores Zgjedhore Nr.17/2024 Regjistrimi dhe Votimi jashtë Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 14.11.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Rekomandimit të Sekretariatit për Hapjen e Kutive Postare Jashtë Kosovës

- I. Miratohet Rekomandimi i Sekretariati, për hapjen e kutive postare jashtë Kosovës.
- II. Kutitë postar do të hapen në njëzete e dy (22) shtete, si në vijim:

Australi, Austri, Belgjikë, Çeki, Danimarkë, Francë, Gjermani, Holandë, Hungari, Itali, Kanada, Kroaci, Mal i Zi, Maqedonia e Veriut, Norvegji, SHBA, Shqipëri, Slloveni, Suedi, Turqi, Mbretëria e Bashkuar, Zvicër.
- III. Hapja e kutive postare bëhet nga një(1) kuti për një (1) për shtet si në pikën II të këtij vendimi dhe do të jetë aktive nga data 1 Janar 2025 deri me datën 31 Dhjetor 2025 dhe do të shërbej për Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2025 dhe Zgjedhjet Lokale 2025.
- IV. Rekomandimi si në pikën I është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- V. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- VI. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 14.11.2024

Kreshnik RADONIQI
Republika e Kosovës
Republika Kosova
Prishtinë
Prishtina
CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA
Kryesues i KQZ



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 67, nenin 68, nenin 69 nenin 70 nenin 71 nenin 72 dhe nenin 73 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 5 paragrafi 1 të Rregullores Zgjedhore Nr.02/2024 Emërimi, Përbërja dhe Funkionimi i Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 14.11.2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për Emërimin e Anëtares së Komisionit Komunal të Zgjedhjeve(KKZ) në Komunën e Parteshit

- I. Znj. Aleksandra Maksimović emërohet anëtare e KKZ-së në komunën e Parteshit, nga OJQ "SOKRAT" për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen më 9 shkurt 2025.
- II. Mandati i anëtaresë së KKZ-së, do të fillojë nga data e emërimit sipas këtij vendimi dhe do të përfundojë pesëmbëdhjetë (15) ditë pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve, përveç nëse mandati i KKZ-së ndërpritet para përfundimit të afatit ose zgjatet me vendim të KQZ-së.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 14.11.2024

Kreshnik RADONIQI

Kryesues i KQZ





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, 64, 70 i Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 6, paragrafi 1.4 dhe neni 8 paragrafi 1 të Rregullores Zgjedhore Nr.02/2024, Emërimi, Përbërja dhe Funksimi i Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve, si dhe kërkesës të datës 09.11.2024, të subjektit politik PAI, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 14.11.2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për Zëvendësimin dhe Emërimin e Anëtarit të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) në Komunën e Lipjan

- I. Z. Ramadan Limani, i emëruar si anëtar i KKZ-së në komunën e Lipjanit nga subjekti politik PAI zëvendësohet me z. Arsim Salihu i cili emërohet për anëtar e KKZ-së nga i njëjti subjekt politik për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 9 shkurt 2025.
- II. Mandati i anëtarit të emëruar të KKZ-së, do të fillojë nga data e emërimit sipas këtij vendimi dhe do të përfundojë pesëmbëdhjetë (15) ditë pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve, përveç nëse mandati i KKZ-së ndërpritet para përfundimit të afatit ose zgjatet me vendim të KQZ-së.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Z. Ramadan Limani, nga subjekti politik PAI është emëruar anëtar i KKZ-së, me vendimin e KQZ Nr.01/289-2024, të datës 16.09.2024, ndërsa me kërkesën të datës 09.11.2024, subjekti politik PAI, ka kërkuar zëvendësimin e tij për arsyeje të dorëheqje së tij nga pozita e anëtarit i KKZ-së për arsyeje personale. Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 14.11.2024

Kreshnik RADONIQI
Kryesues i KQZ
Republika e Kosovës
Republika Kosova
Prishtinë
Prishtina
CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 67, nenin 68, nenin 69 nenin 70 nenin 71 nenin 72 dhe nenin 73 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 5 paragrafi 1 të Rregullores Zgjedhore Nr.02/2024 Emërimi, Përbërja dhe Funksionimi i Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 14.11.2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për Emërimin e Anëtares së Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) në Komunën e Parteshit

- I. Znj. Bojana Bogdanović emërohet anëtare e KKZ-së në komunën e Parteshit, e propozuar nga KKZ për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen më 9 shkurt 2025.
- II. Mandati i anëtares së KKZ-së, do të fillojë nga data e emërimit sipas këtij vendimi dhe do të përfundojë pesëmbëdhjetë (15) ditë pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve, përveç nëse mandati i KKZ-së ndërpritet para përfundimit të afatit ose zgjatet me vendim të KQZ-së.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 14.11.2024

Kreshnik RADONIQI

Kryesues i KQZ
Republika e Kosovës
Republika Kosova
Prishtinë
Prishtina

